



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 195, Datë 22.09.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SH.A. PËR SHTYRJE TË AFATIT TË  
VENDIMARRJES FINALE TË BORDIT TË ERE, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“ALBGAZ” SH.A., NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT  
TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, pika 12, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015, si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/1 prot., datë 13.09.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi “Kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE, për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Në vijim ERE me vendimet nr. 43, datë 06.03.2020, nr. 119, datë 17.07.2020, nr. 179, datë 04.11.2020, vendosi për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a. për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Për shkak se subjekti parashtrori në ERE se shumë projekte fizibiliteti u pezulluan për një kohë më të gjatë se sa ajo e parashikuar për arsye të pandemisë Covid-19, dhe si e tille shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk disponon ende të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ERE.

- ERE është informuar se është në proces kryerja e një Studimi për Hapësirat e Depozitimit të Gazit Natyror dhe përfundimi i këtij studimi do të mundësojë edhe plotësimin e dokumentacionit specifik për licencën e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
- Duke qenë se në kërkesën e shoqërisë për shtyrje të afatit nuk është dokumentuar sa dhënë argumente në lidhje me pamundësinë e plotësimit të dokumentacionit të munguar në aplikim, vlerësohet që shoqërisë “Albgaz” sh.a., t’i lihet detyrë që brenda **datës 20.01.2022**, të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit për një periudhë më të gjatë sipas kërkesës së saj.
- Kërkesa e “Albgaz” sh.a., rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative i cili përcakton se:
 

*3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Shoqëria “Albgaz” sh.a., brenda **datës 20.01.2022**, të depozitojë në ERE dokumentacionin apo argumentet justifikuese (mbi të gjithë dokumentacionin e konstatuar si të munguar në aplikim) me qëllim që të vlerësohet shtyrja e afatit sipas kërkesës së shoqërisë.
2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 20.09.2021.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**